



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË

[Datë: 25.01.2021]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

OPERATORIT EKONOMIK “INFOSOFT OFFICE” SHPK

ADRESA: TIRANE KASHAR, KODER KASHAR, AUTOSTRADA
TIRANEDURRES, KM 8.

OPERATORIN EKONOMIK “MAGRIP BANA” PF

ADRESA: TIRANE NJESIA BASHKIAKE NR.9, RRUGA DONBOSKO,
PALLATI NR.9/443, KATI 0

OPERATORIN EKONOMIK “INTERLOGISTIC” SHPK

ADRESA: TIRANE KASHAR KASHAR AUTOSTRADA TIRANE-DURRES,
RRUGA DYTESORE KM 9, GODINE 3 KATESHE

* * *

Procedura e prourimit: “Procedurë e hapur”- Marrëveshje kuadër me disa operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara

Numri i referencës së procedurës: REF-62453-06-23-2020.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Blerje materiale kancelarie”.**

Fondi limit: 37.499.820 (tridhjetë e shtatë milion e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e njëzet) lekë pa tvsh.

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: Operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë artikujt në magazinën e Bashkisë Tiranë nga data e lidhjes së kontratës brenda marrëveshjes kuadër për një periudhë kohore 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj sipas kërkesave dhe nevojave të Autoritetit Kontraktor.

Publikime të mëparshme: Buletini Nr. 39 datë 29 Qershor 2020

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: ☐ oferta ekonomikisht më e favorshme ☒ çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “Infosoft Office“shpk **NUIS J62426002Q**

Çmimi total i ofertës pa tvsh = **28.691.710,33 (njëzet e tetë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e një mijë e shtatëqind e dhjetë presje tridhjetë e tre) lekë**

2. Operatori ekonomik “Interlogistic” shpk **NUIS K21605003M**

Çmimi total i ofertës pa tvsh = **33.333.000 (tridhjetë e tre milion e treqind e tridhjetë e tre mijë) lekë**

3. Operatori ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” shpk **NUIS K81503063B**

Çmimi total i ofertës pa tvsh = **29.995.632,93 (njëzet e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e dy presje nëntëdhjetë e tre) lekë.**

4. Operatori ekonomik “Magrip Bana” pf **NUIS L41702004L**

Çmimi total i ofertës pa tvsh = **31.629.719 (tridhjetë e një milion e gjashtëqind e njëzet e nëntë mijë e shtatëqind e nëntëmbëdhjetë) lekë.**

5. Operatori ekonomik “Erisoni Company“ shpk **NUIS : K92006501A**

Çmimi total i ofertës pa tvsh= **33.613.502,5 (tridhjetë e tre milion e gjashtëqind e trembëdhjetë mijë e pesëqind e dy presje pesë) lekë**

6. Operatori ekonomik “Marketing &Distribution“ shpk **NUIS: J72124001N**

Çmimi total i ofertës pa tvsh = **36.998.762,19 (tridhjetë e gjashtë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e dy presje nëntëmbëdhjetë) lekë**

Janë s’kualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. Operatori ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” shpk **NUIS K81503063B**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga kjo shoqëri, nga ku rezultoi si më poshtë:

1. IT Gjergji Kompjuter nuk plotëson specifikimet teknike të disa prej artikujve të dorëzuar sipas pikës 2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë fizikisht mostra për zërat që i përkasin artikujve me numër rendor nr.1, nr.2, nr.3, nr.4, nr.5, nr. 6, nr. 7, nr.14, nr.16, nr.17, nr.18, nr.21, nr. 28, nr.68, nr.69, nr.70, nr.91, nr.92, nr.97, nr.100, nr.103, nr.115, nr.122, nr.125, nr. 128, nr.129, nr.131, nr.151, nr.153, nr.155, nr.173 (përcaktuar me shënjën * në tabelën e përgjithshme në shtojcën nr. 10 specifikimet teknike), përkatësisht për:

- artikulli nr.5 “Stilolaps rapidograf, me majë të hollë, ngjyra e bojës të jetë blu e lehtë. Të mos zbehet dhe të mos lëshojë njolla”, pasi mostra e paraqitur nuk është rapidograf
- artikulli nr.14 “Zarf plastik me vrima me trashësi 90mic/ pako me 100 cope”, pasi mostra e paraqitur nuk e ka të specifikuar zarfat janë 90mic.
- artikulli nr.28 “Axhendë format A5 (17.2x24, 320 fq)”, pasi mostra e paraqitur i ka permasat 16.8x24.5
- artikulli nr. 100 “Evidenciator me ngjyra të ndryshme. Të jetë shumë cilësor. Me bojë fluoreshente. Me majë të pjerrët dhe me gjerësi 5 mm. Përmasa afërsisht 13 cm*2 cm”, pasi mostra e paraqitur është me përmasa 12x2 dhe maja 3mm
- artikulli nr.103 “Marker për tabelë me majë jo më të hollë se 2.5 mm. Kuti/4cp”, pasi mostra e paraqitur nuk e ka të specifikuar majen 2.5mm
- artikulli nr.129 “Tabele magnetike xhami 120cmx90cm”, pasi mostra e paraqitur nuk është table magnetike (shtese xhami mbi ëhiteboard). Nuk mban magnetin.

2. Operatori ekonomik «IT Gjergji Kompjuter» shpk nuk ka plotësuar kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.7 të kriterëve të vecanta për kualifikim në rubrikën «Kapaciteti teknik» ku përcaktohet se:

“Operatori ofertues duhet të paraqesë foto për çdo artikull, në të cilat të jetë specifikuar produkti që është paraqitur në ofertë dhe në specifikime teknike. Për artikullin Letër A4 80g/m2, operatori ofertues duhet të paraqesë katalog/broshurë/skedën teknike, në të cilën të gjëjnë pasqyrim specifikimet teknike të kërkuara me produktet e ofruara. Katalogu/ broshura/skeda teknike duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe » .

Dokumenti Skeda Teknike e Letres nuk është firmosur përthimi nga përthyesi i licencuar.

Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese*”. Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, (i ndryshuar), përcaktohet se: “*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...*

Sa me sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2. Operatori ekonomik “Erisoni Company” shpk

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga kjo shoqëri, nga ku rezultoi si më poshtë:

1. Erisoni Company shpk nuk ka paraqitur deklarate se mallrat që do të dorëzojë janë të njejte me mostrat e paraqitura ditën e zhvillimit të procedurës së prokurimit.
2. Erisoni Company nuk ka paraqitur deklarate me ane të se ciles merr persiper të kryejë shërbimin e transportit të të gjithë artikujve të kërkuar në adresën e AK-se.
3. Erisoni Company nuk plotëson specifikimet teknike të disa prej artikujve të dorëzuar sipas pikës 2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë fizikisht mostra për zërat që i përkasin artikujve me numër rendor **nr.1, nr.2, nr.3, nr.4, nr.5, nr. 6, nr. 7, nr.14, nr.16, nr.17, nr.18, nr.21, nr. 28, nr.68, nr.69, nr.70, nr.91, nr.92, nr.97, nr.100, nr.103, nr.115, nr.122, nr.125, nr. 128, nr.129, nr.131, nr.151, nr.153, nr.155, nr.173** (përcaktuar me shënjën * në tabelën e përgjithshme në shtojcën nr. 10 specifikimet teknike), përkatësisht për:
 - artikulli nr.14 “Zarf plastik me vrima me trashësi 90mic/ pako me 100 cope”, pasi mostra e paraqitur nuk e ka të specifikuar që zarfat janë 90mic.
 - artikulli nr.28 “Axyhendë format A5 (17.2x24, 320 fq)”, pasi mostra e paraqitur i ka përmasat 19x27
 - artikulli nr.97 “USB 32GB . Me tastierë të integruar për vendosje passëordi. Algoritmi i Kriptimit 256-bit. Lloji i ndërfaqes USB-C 3.1”, pasi mostra e paraqitur është USB e thjeshtë 2.0
 - artikulli nr. 100 “Evidenciator me ngjyra të ndryshme. Të jetë shumë cilësor. Me bojë fluoeshente. Me majë të pjerrët dhe me gjerësi 5 mm. Përmasa afërsisht 13 cm*2 cm”, pasi mostra e paraqitur ka përmasat 11.5x2.5
 - artikulli nr.103 “Marker për tabelë me majë jo më të hollë se 2.5 mm. Kuti/4cp”, pasi mostra e paraqitur nuk e ka të specifikuar majën minimalisht 2.5mm
 - artikulli nr.129 “Tabele magnetike xhami 120cmx90cm”, pasi mostra e paraqitur nuk është table magnetike dhe as xhami.
4. Operatori ekonomik «Erisoni Company» shpk nuk ka plotësuar kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.7 të kriterëve të vecanta për kualifikim në rubrikën «Kapaciteti teknik» ku përcaktohet se:

”Operatori ofertues duhet të paraqesë foto për çdo artikull, në të cilat të jetë specifikuar produkti që është paraqitur në ofertë dhe në specifikime teknike. Për artikullin Letër A4

80g/m2, operatori ofertues duhet të paraqesë katalog/broshurë/skedën teknike, në të cilën të gjëjnë pasqyrim specifikimet teknike të kërkuara me produktet e ofruara. Katalogu/broshura/skeda teknike duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe » .

Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”*. Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, (i ndryshuar), përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...* Sa me sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. Operatori ekonomik “Infosoft Office“shpk NUIS J62426002Q

Çmimi total i ofertës pa tvsh = **28.691.710,33 (njëzet e tetë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e një mijë e shtatëqind e dhjetë presje tridhjetë e tre) lekë**

2. Operatori ekonomik “Magrip Bana” pf NUIS L41702004L

Çmimi total i ofertës pa tvsh = **31.629.719 (tridhjetë e një milion e gjashtëqind e njëzet e nëntë mijë e shtatëqind e nëntëmbëdhjetë) lekë.**

3. Operatori ekonomik “Interlogistic” shpk NUIS K21605003M

Çmimi total i ofertës pa tvsh = **33.333.000 (tridhjetë e tre milion e treqind e tridhjetë e tre mijë) lekë**

4. Operatori ekonomik “Marketing &Distribution“ shpk NUIS: J72124001N

Çmimi total i ofertës pa tvsh = **36.998.762,19 (tridhjetë e gjashtë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e dy presje nëntëmbëdhjetë) lekë**

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqiteni pranë Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë, Drejtoria e Prokurimeve, Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 20.08.2020

Ankesa: Në lidhje me vlerësimin e bërë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave kanë paraqitur ankesë pranë AK 3 (tre) operatorë ekonomikë të cilët kanë patur interes të ligjshëm për të kontestuar vendimin e marrë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave. Pas marrjes së përgjigjes me shkrim nga Autoriteti Kontraktor dy prej operatorëve ekonomikë në statusin e palës ankimese kanë ushtruar të drejtën e tyre legjitime për t'u ankimuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik i cili në dt 13.11.2020 me anë të vendimit Nr 517/2020 ka pranuar ankesën e bërë nga të dy operatorët ekonomikë si dhe ka urdhëruar AK të kryejë procesin e rivlerësimit. Në datë 17.11.2020 Komisioni i Vlerësimit të Ofertave realizoi rivlerësimin e procedurës së prokurimit në portalin elektronik të Agjensisë së Prokurimit Publik si edhe e dokumentoi atë nëpërmjet procesverbalit të rivlerësimit datë 17.11.2020 (i administruar në dosjen e procedurës së prokurimit). Mbas kryerjes së rivlerësimit të procedurës së prokurimit operatori ekonomik “Interlogistic” shpk ka ngritur pretendime të reja të cilat nuk ishin objekt ankimi në vendimin e marrë nga AK dhe Komisioni i Prokurimit Publik duke ezauruar të gjitha shkallët e ankimit administrativ. Komisioni i Prokurimit Publik pasi ka marrë në shqyrtim të gjitha parashtrimet me shkrim të ankimesit, dokumentacionin e paraqitur nga AK pretendimet e ankimesit, ka vendosur të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Interlogistic” shpk si dhe ka lejuar Autoritetin Kontraktor Bashkia Tiranë të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit me anë të vendimit Nr 29/2021.